



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr-28/2008, dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr-27/2008, nenit, 28, paragrafi 2, pika (c), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2021 miratoi këtë:

## V E N D I M

**Për ri- alokimin e mjeteve nga fondi burimor (22), të hyrat veanake të vitit 2019 në Subvencione dhe Transfere në vitin fiskal 2021**

### Neni 1

1.1 Në bazë të buxhetit të Rishikuar dhe konform ligjit NR.07/L-014 të Rishikuar për Ndarjet Buxhetore për vitin 2020, mjetet vetanaka nga fondi burimor (22) të cilat janë bartur edhe nga vitet e më parshme për projekte kapitale do të transferohen(barten) në Subvencione dhe Transfere shuma prej **80,000.00 €** si pasojë e mos shpenzimit të tyre gjat vitit 2020 .

1.2 Shuma e lartëshenuar do të alokohet-transferohet nga projektet kapitale të cekura më lart në kategorin ekonomike –Subvencione & Transfere nga njësit buxhetore si më poshtë :

### Lista e projekteve kapitale nga fondi burimor 22 (THV)

Ko. Projektit	EMRI I PROJEKTIT Fondi burimor 22	
	<b>Shërbimet Publike dhe Emergjencia</b>	<b>SHUMA €</b>
47560	PASTRIMI DHE RREGULLIMI I LUMENJEVE NE KOMUNË (Reqan, Mushtisht, Ternje)	(36,771.68)
85706	MBUKQYRJA E PROJEKTEVE INVESTIVE	(11716.12)
	<b>TOTALI:</b>	<b>(48,487.80)</b>
	<b>SUBVENCIONE &amp; TRANSFERE</b>	<b>48,487.80</b>
	<b>Planifikimi Urban-Urbanizmi Fondi burimor 22</b>	<b>SHUMA €</b>
89823	HARTIMI,HARMONIZIMI I DOKUMENTAVE TË PLANIT HAPSINOR	(31,512.20)
	<b>SUBVENCIONE &amp; TRANSFERE</b>	<b>31,512.20</b>
	<b>TOTALI:</b>	<b>(80,000.00)</b>



## Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

## Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËSNË SUHAREKË

01-Nr- 400-7538  
Më datë 29.01.2021



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. **ec Bexhet KUÇI**